



MINISTRI E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	ARM
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	- 04 -
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	8314-2/v
Datë Datum Date	06.07.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.04.2025
REFERENC-Ë:	8314/24 - ZSP- ARPL / 2025
-PËR/ZA/TO:	K.R.U. „GJAKOVA” Sh.a. K. Gjakovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, U.D. Drejtori ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të Drejtën Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Pelqim Ujor

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 8314/24, datë 17.12.2024 nga pala, K.R.U. „GJAKOVA” Sh.a. K. Gjakovë, për projektin e strukturës mbrojtëse nga përmbytjet e Lumit Erenik, në objektin ITUN (Impinti i trajtimit të ujërave të ndotura), dhe ka vendosur si në Vendim për Pëlqim Ujor të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. P.U.

Datë: 23.04.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PELQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palës K.R.U. „GJAKOVA“ Sh.a. K. Gjakovë me, Nr. prot. 8314/24, dt. 17.12.2024, për PËLQIM UJOR, për ndërtimin e strukturës mbrojtëse -Argjinatures, në gjatësin L= 517m, afër Lumit Erenik, për mbrojtjen nga përmbytjet të sistemit të objekteve, në kuadër të ITUN (Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura), sipas kushteve vijuese:

Pëlqimi Ujor jepet me këto kushte:

1. Bazuar në nenin 5, paragrafi 3 i U.A. nr. 05/2016 për rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, ku për të gjitha ujërrjedhat, brezi breg-ujor është **5 metra** nga shtrati i ujërrjedhës; distancë e cila duhet rrespektuar, sipas llogarive hidrologjike dhe hidraulike për vendosjen për këtë lloj infrastrukture nga pala;
2. Nuk lejohet asnjë aktivitet mbi pronat ujore, apo shfrytëzimi i tyre, ashtu sikurse e parasheh legjislacioni për ujërat e Kosovës;

3. Ndërtimi i argjinaturs, duhet të bëhet në bazë të projektit kryesor në harmoni me Ligjin e Ndërtimit dhe pas përfundimit duhet të informohet edhe MMPH/ARPL-ja ;
4. Pëlqim ujqor ka afat dy vjeçar, nëse deri atëherë nuk ka filluar ndërtimi i tijë;
5. Përgjegjësia për dëmet e mundëshme që mund të shkaktohen nga vërshimet do te bien mbi palën;
6. Për këtë pala duhet të ketë objektin nën mbikqyrjen e plotë, me që është pjesë e sistemit infastrukturor në kuadër të ITUN (Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura).

Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 Për procedurat për leje ujore, nen 5, paragrafi 3 i U.A. 05/2016 në fuqi, për rregullimin e statusit të pasurisë ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Pëlqim Ujqor – Ndërtimi i strukture mbrojtëse nga përmytjet e lumit Erenik në ITUN – Gjakova; Kërkesës ia ka bashkangjitur: Punët për Mbrojtjen nga përmytjet; materialet; punët e dheut; testimi dhe futja ne funcion; Vizatimet, si : Prerja terthore e argjinatures; Planimetria; Profili: Profilet Karakteristike, tërthore; Gabionet; Pagesen me rastin e aplikimit në vlere 50+150 €, ashtu siç kërkohet për vlerë të kost benefitit të projektit, sipas Shtojces gjasht të “U.Ad. MMPH, 03/2018 Për procedurat për leje ujore” (Dy faturat iu janë bashkangjitur dok. investiv teknik);

Andaj bazuar në kërkesën e palës lidhur me ndërtimin e argjinatures, përgjatë lumit Erenik, në cilësinë e strukture mbrojtëse nga përmytjet e mundëshme të sistemit të objekteve të kompleksit të ITUN, që mund të jenë të rrezikuara; Shikimit në vend, me datë 05.03.2025, me ç’rast është mbajtur edhe procesverbali i nënshkruar nga zyrtarë të ARPL-së dhe Palës, është vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi.

Verejtje : Bazuar në pronocimin e drejtorit, duke u bazuar në takimet që kemi pasur dhe informatat faktike që ju kan ofruar nga unë si zyrtare përgjegjëse, si dhe sqarimin që ka bërë udhëheqësja e DMRU-së, lëndët janë procesuar për nënshkrim, të cilat ishin kthyer, me 01.04.2025 nga ZSP-ja.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 8314/24 - ZSP- 2025 Datë, 23.04.2025

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Gjakovë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zavendësues - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së



Izedin BYTYQI